



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 074/8
Prishtinë, më 11 qershor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 DHE 18 QERSHOR 2009

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup Krasniqi**, kurse i ndihmoi anëtari i Kryesisë së Kuvendit, zoti **Naim Maloku**.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Për fjalë u paraqitën deputetët: Esat Brajshori, Ramë Buja, Branislav Gërbiç, Ardian Gjini dhe Fatmir Rexhepi.

Esat Brajshori propozoi që pika e tetë e rendit të ditës - Shqyrtimi i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2008, të hiqet nga rendi i ditës, sepse Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media dhe Komisioni për Buxhet e Financa, kanë konstatuar se ky raport nuk i plotëson kushtet ligjore të raportimit.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Esat Brajshori. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----19,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, hoqi nga rendi i ditës shqyrtimin i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2008, me arsyetimin se ai duhet të plotësohet.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi që pika e shtatë e rendit të ditës- Shqyrtimi i Projekt rregullores së Kuvendit, të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Ramë Buja. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----20,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi heqjen e pikës shtatë nga rendi i ditës.

Deputeti **Branisllav Grbiq** tha se bashkësisë serbe në Kryesinë e Kuvendit i takojnë dy anëtarë të Kryesisë. Megjithatë, sipas tij kjo çështje kërkon analiza më të thella.

Kryesuesi lidhur me këtë tha se kërkesa duhet bërë me shkrim e pastaj të analizohet dhe të procedohet.

Deputeti **Ardian Gjini** tha se për parlamentarizmin nuk është shenjë e mirë të tërhiqen dy pika nga rendi i ditës.

Kryesuesi lidhur me këtë tha se rregulla 30. 2. e Rregullores së Punës së Kuvendit ia lejon të drejtën deputetit të paraqesë propozime të këtilla.

Deputeti **Fatmir Rexhepi** kërkoi të dijë më shumë detaje rreth vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri, që goditi kohë më parë komunën e Gjilanit.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** lidhur me këtë çështje tha se Qeveria e Kosovës ka themeluar një komision për vlerësimin e këtyre dëmeve në komunën e Gjilanit dhe ai sapo ta përfundojë punën, raportin do t'ia procedojë Kuvendit..

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën sociale në Kosovë,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,

7. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores së Kuvendit,
8. Shqyrtimi i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2008,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës,
10. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012 (shpërndarë deputetëve më 13 maj 2009),
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, për vitin 2008 (shpërndarë deputetëve më 15 maj 2009),
12. Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion, për vitin 2008,
13. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës,
14. Njoftimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në Komisionin parlamentar,
15. Njoftimi me shpërbërjen e Grupit Parlamentar “Zajedno”.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 14, 15, 22 dhe 27 maj 2009 dhe seancës plenare të mbajtur më 4 qershor 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 14, 15, 22 dhe 27 maj 2009 dhe të seancës plenare të mbajtur më 4 qershor 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Naser Rugova** parashtroi pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, **Sadri Ferati**, lidhur me veprimet e Qeverisë dhe të Ministrisë për normalizimin e jetës dhe përkujdesjen e institucionale për banorët e fshatrave: Koshtovë, Cerajë dhe Bistricë të komunës së Leposaviqit.

Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova..

Deputetja **Drita Maliqi** parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, **Nenad Rashiq**, lidhur me procedimin e Projektligjit për pensionistët, në Kuvendin e Kosovës.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Drita Maliqi.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** parashtroi pyetje për ministren e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, lidhur me fazën e përgatitjes së Projektligjit kundër dhunës në familje.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Nerxhivane Dauti.

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtroi pyetje për ministrin e Administratës Publike, **Arsim Bajrami**, lidhur me kohën e fillimit të regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë.

Ministri Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Gjylnaze Syla.

Deputetja **Synavere Rysha** parashtoi pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Loka, **Sadri Ferati**, lidhur me vendin e punës së drejtoreshës së Çerdhes së Fëmijëve në Kaçanik.

Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetes Synavere Rysha.

Deputetja **Sanije Aliaj** parashtoi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi**, lidhur me përshejtimin e Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, në Kuvend.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Sanije Aliaj.

Deputetja **Kosara Nikoliq** parashtoi pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, **Mahir Yagcilar**, lidhur me vendosjen e kontejnerëve për mbeturina në mjediset rurale, ku jeton komuniteti serb.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Nikoliq.

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për zëvendëskryeministrin, **Hajredin Kuçi**, lidhur me shkallën e besimit të qytetarëve të Kosovës në institucionet publike.

Zëvendëskryeministrin tha se në këtë pyetje përgjigjet Kryeministri Hashim Thaçi.

Kryeministri **Hashim Thaçi** u përgjigj në pyetjen e deputetit Riza Smaka.

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi**, lidhur me shkallën e pesimizmit të qytetarëve të Kosovës me rrjedhat politike.

Kryeministri Hashim Thaçi u përgjigj në pyetjen e deputetit Smaka.

3. Shqyrtimi i Parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën sociale në Kosovë

Kryesuesi **Naim Maloku** ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin e lartpërmendur.

Me propozim të ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, **Nenad Rashiq**, Kuvendi shtyu shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën sociale në Kosovë për ndonjë seancë tjetër të radhës, me arsyetimin se duhen të miratohen edhe disa projektligje të tjera, që dalin nga Letra e Bardhë.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** tha se edhe me procedimin e këtij projektligji në Kuvend vazhdon përkushtimi i Ministrisë së Drejtësisë, për kompletimin e infrastrukturës ligjore.

Me këtë projektligj kërkohet që të gjithë zyrtarët e lartë të deklarojnë pasurinë e tyre me rastin e emërimit, por edhe me rastin e largimit të tyre nga një post. Projektligji, tha ajo është hartuar në bashkëpunim edhe me ekspertët ndërkombëtarë.

Në vazhdim tha se ky projektligj do të rrisë mënyrën e efikasitetit në gjyqësor, qoftë edhe në mënyrë preventive, por, gjithashtu edhe besueshmërinë tek qytetarët. Më tej tha se është në përgatitje e sipër edhe plotësim ndryshimi në Ligjin kundër korrupsionit, i cili do t'u dërgohet së shpejti në Kuvend, në mënyrë që gjatë fazës së punës në Komisione këto dy projektligje do të mund të harmonizoheshin më mirë me njëra-tjetrën.

Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar "7+", **Xhezair Murati**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të SLS, **Bojan Stojanović**, si dhe deputetët: **Suzan Novobrdaliu**, **Sanije Aliaj**, **Emrush Xhemajli**, **Gjylnaze Syl**a, **Fatmir Regjepi**, **Bajram Kosumi**, **Edita Tahiri**, **Riza Smaka**, **Naser Rugova**, **Ardian Gjini**, **Ethem Çeku dhe Adem Hajdari**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,

Kundër-----2,

Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** tha se ky projektligj është rezultat i punës së vazhdueshme të Ministrisë për rumbullakimin sa më me sukses të legjislacionit, si ministri sponsorizuese. Sa i përket vetë nocionit konflikt i interesit, si i tillë është evident dhe në këtë projektligj, mirëpo po bëhen përpjekje për ta eliminuar atë. Ky projektligj

përcakton qartë se personat zyrtarë nuk mund të përfaqësojnë shoqëri tregtare, firma, e të tjera, përjashtimisht kur janë anëtarë të një bordi, ose të një agjencie publike, tha ministria Kelmendi. Në vazhdim tha se me këtë projektligj parashihet që nëse Agjencioni Kundër Korrupsionit, në raste kur konstaton se një zyrtar ndeshet me konflikt interesi, atëherë duhet kërkuar procedura e shkarkimit të atij zyrtari. Ky projektligj përcakton parimet themelore në ushtrimin e funksionit publik dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Pra, do të rrisë punën e prokurorëve dhe të gjykatave dhe besimin e qytetarëve në punën e institucioneve.

Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobrdaliu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të SLS, **Bojan Stojanoviq**, si dhe deputetët: **Naim Rrustemi**, **Gjylnaze Sylja**, **Riza Smaka**, **Bahri Hyseni** dhe **Fatmir Regjepi**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Kthim dhe Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit funksional për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor ose raportuesin e Komisionit , që ta marrë fjalën.

Pasi as nga Komisioni funksional, e as nga deputetë tjerë nuk pati të paraqitur për ta marrë fjalën, **Kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural, dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----1,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta marrë fjalën.

Bahri Hyseni tha se Raportin e parë e kemi shqyrtuar në Komision dhe më 27 maj 2008 e kemi dërguar për herë të parë në Kuvend. Më pas propozimi është hequr nga Ministria e Drejtësisë. Kësaj here, tha ai, janë tre kandidatë për të cilët kemi dilema, e këta janë: Ruzhdi Berisha, Fetije Sadik dhe Qerim Qerimi. Bazueshmëria dhe arsyeshmëria e këtyre dilemave është sqaruar në raportin e këtij komisioni. Në fund ai theksoi se këshilltarët politik të ministrave nuk kanë të drejtë të nënshkruajnë propozimvendime apo dokumente të tjera zyrtare të cilat i drejtohen Kuvendit, gjë që ka ndodhur deri më tani.

Kryesuesi **Jakup Krasniqi** lidhur me nënshkrimin e dokumenteve zyrtare apo propozimvendimeve nga këshilltarët politik tha se materialet e tilla duhet të kthehen mbrapa.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** tha se është e vërtetë se propozimet e Ministrisë së Drejtësisë për këtë çështje janë kthyer disa herë nga Komisioni funksional apo nga Kuvendi, por lista e propozuar së fundi, i plotëson kriteret nga neni 7.6 i Ligjit për provimin e jurisprudencës. Në vazhdim tha se edhe tre kandidatët e kontestuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi: Ruzhdi Berisha, Fetije Sadik dhe Qerim Qerimi i plotësojnë kushtet të jenë pjesë e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Kryesuesi hapi debat për Shqyrtimin e raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Gjylnaze Sylja**, **Riza Smaka** dhe **Numan Baliq**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi **Naim Maloku** hodhi në votim Raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----40,

Kundër-----13,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës

I. Formohet Komisioni për dhënien e provimit të jurisprudencës, në këtë përbërje:

1. Rexhep Haxhimusa- kryetar i Komisionit, pyetës për lëndën E drejtën Penale, (materiale dhe procedurale),
- zëvendës i tij, Mejdin Dehari,
2. Abedin Ferović- anëtar i Komisionit, pyetës për lëndët: Parimet dhe Struktura Kushtetuese dhe Organizimi i Gjyqësorit,
- zëvendës i tij Rafet Haxhić,
3. Muharrem Shala- zëvendësanëtar i Komisionit, për lëndën: E drejta Civile (materiale dhe procedurale), familjare, trashëgimore dhe e Drejta Detyrimore,
4. Suzana Kajtazi-Sejdić- anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës: E Drejta Tregtare (Ekonomike),
5. Meleqe Behxheti-anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës: E drejta e Punës, zëvendës e saj Gylten Sylejmani,
6. Mirlinda Batalli- anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës: E drejta Administrative, zëvendës i saj Osman Tmava,
7. Iliriana Islami- anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndëve: E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë që t'i propozojë kandidatët e Komisionit në cilësinë e pyetësit për lëndët: E Drejta Civile, Familjare, Trashëgimore dhe e Drejta Detyrimore, për zëvendës anëtarë për lëndët: E drejta Tregtare (Ekonomike), si dhe zëvendës anëtarë për lëndët E drejta Ndërkombëtare dhe e Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

III. Mandati i anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës dhe të zëvendësve të tyre zgjatë dy (2) vjet.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se pika 10 dhe 11 e rendit të ditës shqyrtohen pas orës 17.

12. Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion, për vitin 2008

Kryesuesi, ftoi Kryetaren e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta marrë fjalën.

Nga Komisioni funksional nuk pati të paraqitur për fjalë.

Kryesuesi hapi debat për Raportin e Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion, për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Bojan Stojanoviq**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi dha një pauzë prej 15 minutash.

Pas pauzës, **Kryetari** ftoi deputetët të vazhdojnë me këtë pikë të rendit të ditës. Ai tha se rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri Energjetikë, Transport e Telekomunikacion dhe të Komisionit për Buxhet e Financa, janë që kjo çështje të shqyrtohet e debatohet në Kuvend dhe Kuvendi të vendosë më tutje.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport, më tej dhanë edhe këta deputetë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Berisha-Shala**, në emër të Komisionit për Buxhet e Financa, **Gani Koci**, si dhe deputetët: **Zef Morina**, **Synavere Rysha**, **Myzejene Selmani**, **Ethem Çeku**, **Besa Gaxheri** dhe **Sabri Hamiti**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kjo pikë e rendit të ditës nuk u hodh në votim dhe me kaq mori fund shqyrtimi i saj.

Në vazhdim Kuvendi zhvilloi punimet lidhur me pikën e dhjetë të rendit të ditës-

10. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010

Kryetari ftoi ministrin e Ekonomisë e Financave, që në emër të Qeverisë që ta marrë fjalën.

Ministri **Ahmet Shala** tha se është hera e parë që Qeveria e Kosovës dërgon në Kuvend një Kornizë afatmesme të shpenzimeve, për dy vjetët e ardhshme buxhetore. Tha se kërkesat e qytetarëve në Kosovë janë të shumta, andaj kjo kornizë vendos një ekuilibër në mes të kërkesave dhe shpenzimeve fiskale të Qeverisë së Kosovës. Më tej ai elaboroi prioritetet e Qeverisë, siç është zhvillimi i hovshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik. Kjo kornizë e shpenzimeve publike përmbush nevojën e të gjitha organizatave buxhetore. Ky dokument tha ai, merr parasysh obligimet tona drejt integriteteve evropiane. Dokumenti është i përbërë prej katër pjesëve.

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë në kohën kur kriza botërore ka qenë në kulminacionin e saj. Rritje pritet të ketë, tha ai edhe në sektorin privat.

Sa i përket rritjes ekonomike, ministri tha se me përjashtim të Shqipërisë, vendet e rajonit kanë shënuar një zvogëlim të rritjes ekonomike, në ndërkohë që Kosova ka pasur një rritje prej 4,3%. Ai tha se për vitin 2009 presin rritje të të hyrave buxhetore prej 6%.

Kryesuesi hapi debat për Shqyrtimin e propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë. Në emër të Komisionit për Buxhet e Financa, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik**, si dhe deputetja, **Suzan Novobrdaliu**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Deputeti **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, propozoi që seanca plenare ta ndërpresë punën , në mënyrë që të vazhdohet në tjetër ditë.

Kryesuesi **Naim Maloku** e hodhi në votim propozimin që seanca të vazhdojë punimet për datën 18 qershor 2009(e enjte) në orën 10,00.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----35,
Kundër-----4,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi propozimin që seanca të ndërpritet për ditën e sotme dhe të vazhdojë punimet me datën 18 qershor 2009 (e enjte), në orën 10,00.

Kryesuesi e mbylli seancën në orën 19: 31 minuta.

E enjte, 18 qershor 2009

Vazhdim i seancës

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, **Jakup Krasniqi**, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 67 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Për fjalë u paraqit deputeti **Adem Grabovci**, i cili tha se do të shpalos para deputetëve një çështje të pazakonshme se mbrëmë kam pasur një thirrje telefonike për kërcënim fizik nga kryetari i komunës së Deçanit, z. Musa Berisha.

Deputeti **Ethem Çeku** tha se Musa Berisha dhe Adem Grabovci kanë qenë shokë të mirë dhe nuk beson se Musa Berisha i ka bërë telefonatë kërcënuese Adem Grabovcit.

Kryetari tha se vazhdon debati nga ana e deputetëve për këtë pikën e 10 –të të rendit të ditës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim vendim dhanë këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Ethem Çeku, Naser Rugova, Rita Hajzeraj, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Driton Tali, Adem Salihaj, Gani Buçinca, Mimoza Ahmetaj, Naim Rrustemi, Fatmir Limaj, Bajram Kosumi, Flora Brovina , Lulzim Zeneli, Berim Ramosaj dhe Ibrahim Gashi,** si dhe ministri **Ahmet Shala,** të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari mbylli debatin pa votim.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, për vitin 2008 (shpërndarë: më 15 maj 2009)

Kryetari ftoi ministrin e Ekonomisë e Financave, që në emër të Qeverisë ta marrë fjalën.

Ministri **Ahmet Shala** tha se ky është raporti i parë i hartuar për auditimin i bërë për sektorin publik për vitin 2008 dhe është si rezultat i njësive të auditimit nëpër ministrinë përkatëse. Në vazhdim tha se aktivitetet rreth auditimit të brendshëm kanë filluar në maj të vitit 2008 në MEF, në përputhje me Ligjin për auditimin e brendshëm. Ai tha se krijimi i njësisë harmonizuese është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, por edhe konform ligjit. Deri më tani janë krijuar 50 njësi për auditim të brendshëm në nivelin qendror dhe atë lokal dhe janë trajnuar 105 auditorë në disa fusha të ndryshme-tha ministri.

Tani pritet të fillojë projekti për certifikimin e auditorëve të brendshëm, i cili do të financohet nga Komisioni Evropian.

Kryesuesi hapi debat për shqyrtimin e raportit vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, për vitin 2008

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj,** në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj,** në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri,** në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli,** në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha,** në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati,** ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Radmila Vujović si dhe deputetët: **Bahri Hyseni,** Kaqusha Jashari, Myzejene Selmani, Riza Smaka dhe Rita Hajzeraj, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, për vitin 2008

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,

Kundër-----2,

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës për vitin 2008.

13. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës.

Kryetari ftoi kryetarët apo përfaqësuesit e komisioneve, të grupeve parlamentare dhe deputetët që ta marrin fjalën.

Nuk pati asnjë deputet të paraqitur për diskutim.

Kryetari hodhi në votim shqyrtimin e Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,
Kundër-----1,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Propozimvendimi i Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës.
2. Për përkrahjen e projektit nga pika një (1) e këtij vendimi, mjetet financiare ndahen si në vijim:
 1. Për Zyrën e Kryeministrit /Zyrën për Çështje të Komuniteteve 100.000 (njëqindmijë) euro,
 2. Për Ministrinë e Shërbimeve Publike 100.000 (njëqindmijë) euro,
 3. Për Rezervat e paparashikuara të Qeverisë 165.000 (njëqind e gjashtëdhjetepesë mijë) euro,
 4. Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro,
 5. Për Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor 50.000 (pesëdhjetëmijë) euro,
 6. Për Kuvendin Komunal të Novobërdës 3.000 (tremijë) euro.
3. Qeveria e Norvegjisë do ta përkrahë këtë projekt më 75.000 (shtatëdhjetë e pesëmijë) euro.

4. Mjetet financiare sipas pikës dy (2) të këtij vendimi barten në Kodin buxhetor 15 600 në Zyrën për Çështje të Komuniteteve, pranë Zyrës së Kryeministrit, e cila është bartëse e realizimit të këtij projekti.
5. Kryefamiljarët të cilët do të përfitojnë nga ky projekt janë të përfshirë në aneksin që i është bashkangjitur vendimit të Qeverisë të Kosovës, nr. 10/57, datë 13.3.2009.

14. Njoftimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionin parlamentar

Kryesuesi njoftoi deputetët me propozimin e Grupit Parlamentar i AAK-së dhe të Grupit Parlamentar i LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve të tyre në komisionet parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me propozimin e Grupit Parlamentar i AAK-së dhe të Grupit Parlamentar i LDK-s, mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti Danush Ademi emërohet anëtar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, nga GP i AAK-së.
2. Deputetja Fatmire Berisha emërohet anëtare në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetit Armend Zemaj, nga GP i LDK-së.
3. Deputeti Naser Osmani emërohet zëvendës kryesues në Komisionin për Buxhet e Financa, nga GP i LDK-së.
4. Deputeti Armend Zemaj emërohet anëtar në Komisionin për Buxhet e Financa, nga GP i LDK-së.

Kryesuesi mbylli punimet e seancës plenare në orën 17: 45 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**